

## Pasqyrimi gjinor në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare



Punoi: Emiljano Kaziaj, PhD

## HYRJE

Ky projekt ka marrë në konsideratë tre emisione që transmetohen në prime-time, në televizionet Top Channel, Ora News dhe TV Klan, përkatësisht emisionet: Open, 360 ° dhe Opinion. Dy prej emisioneve drejtohen nga moderatorë burra dhe njëri prej emisioneve drejtohet nga një moderatore grua.

Formati i monitorimit, ishte i njehsuar për të gjithë programet dhe kishte në fokus të matjes dhe analizës këto elementë:

- Pjesëmarrjen në terma **sasiore** të burrave dhe grave në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare.
- Pjesëmarrjen në terma **cilësorë** të burrave dhe grave në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare.
- Analizë krahasuese e **qasjes së moderatorëve** të këtyre emisioneve kundrejt të ftuarëve burra dhe të ftuarave gra, konkretizuar me pyetjet që iu bëhen të dy grupeve dhe qëndrimet ndaj të dy grupeve.
- Analizë e diskursit të moderatorëve të emisioneve apo të ftuarëve kundrejt grave në program, konkretizuar me shprehi apo qëndrime të tyre.

### **Analiza dhe gjetjet e këtij studimi janë me interes të madh sepse:**

- Japin një pamje të qartë të pjesëmarrjes dhe aksesit të grave në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare dhe karakteristika të kësaj pjesëmarrjeje.
- Japin një pamje të qartë të mendësive ekzistuese për gratë në Shqipëri, të normalizuara dhe përforcuara nga narrativa e këtyre programeve.
- Përshkruajnë se në cilat tema apo fusha të diskursit publik gratë janë më të predispozuar për t'u përfshirë në media në Shqipëri.
- Identifikojnë problematika strukturore të mediave në Shqipëri, përse i përket çështjeve gjinore dhe trajnimit të grave.

- Identifikojnë dhe japin shembuj të narrativave seksiste, objektifikuese apo homofobe në emisionet prime-time në Shqipëri.

Si i tillë ky studim dhe raporti në veçanti, mund të japë një ndihmesë të madhe për të gjithë aktorët dhe institucionet që punojnë në këtë fushë dhe janë të interesuar për përmirësimin e situatës.

Monitorimi është kryer për periudhën Mars- Korrik 2020. Në këtë studim u analizuan 109 emisione në total nga të tre programet e marra në shqyrtim.

Përpara fillimit të procesit të monitorimit, tre monitoruese të angazhuara në këtë projekt, janë njohur me formatin e raportimit në mënyrë domethënëse dhe gjatë një sesiioni të shkurtër trajnimi, kanë analizuar konkretisht një nga emisionet, duke e përdorur këtë përvojë si një test, për procesin e monitorimit të mëtejshëm.

## PERMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE TE STUDIMIT

Nuk mund të mos bjerë në sy si gjetje e parë në këtë studim për pasqyrimin e çështjeve gjinore në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare, imazhet (logot) e tre emisioneve të monitoruara, të cilat janë përdorur edhe si faqosje e këtij studimi.

Është me interes të theksohet se për dy emisionet që drejtohen nga burra- **Opinion** dhe **360°**, të dy burrat shfaqen edhe në logon e emisionit, siç prezantohet në faqet e televizioneve përkatëse dhe promovohet në mediat sociale apo kanalet e tjera të këtyre mediave. Ndërkohë, për emisionin **Open**, i cili ka një grua si drejtuese, logo zyrtare e emisionit- siç shfaqet në programacionin e televizionit Top Channel- nuk ka imazh/fotografi të moderatores.

Ky është një rast studimi interesant i cili mund të thellohet edhe më tej dhe të analizohen këto qëndrime përkatëse. Profesionistët e marketingut që punojnë me programacionin në televizione zgjedhin drejtuesit e emisioneve si imazh për t'i dhënë besueshmëri emisionit dhe për t'i rritur audiencën, duke u mbështetur tek suksesi dhe popullariteti i drejtuesit/drejtueses së emisionit. Nuk mendojmë se popullariteti i Eni Vasilit, është më poshtë sesa ai i dy moderatorëve burra, në Shqipëri, ndaj kjo zgjedhje, për mosparaqitjen e saj në logon e emisionit duhet parë përtej kësaj arsyeje. Një argument mund të jetë perceptimi që shoqëria shqiptare ka për burrat dhe gratë dhe mënyra se si i shikon këto dy kategori. Ndërkohë që burrat shihen si më të fortë, më të besueshëm dhe më autoritativë, gratë, nuk perceptohen njësoj. Këto dy logo, që shfaqin burrat në to, e përforcojnë edhe më tej këtë perceptim.

Por, kjo mund të jetë fare mirë edhe një zgjedhje e vetë moderatores, për të mos qenë pjesë e logos, me imazhin e saj. Edhe kjo zgjedhje, që në pamje të parë mund të duket si e vullnetshme, sërish nuk mund t'ë mos i kushtëzohet mentaliteteve ekzistuese, që përmendem më sipër për burrat dhe gratë në Shqipëri.

Në çdo rast, ky shembull është tipik i mënyrës se si media ndihmon- nëpërmjet zgjedhjeve që bën me imazhet- në pasqyrimin e roleve gjinore dhe përforcimin e perceptimit të shoqërisë për këto role.

## PJESEMARRJA

- Gjithsej në 109 seritë e tre emisioneve të monitoruara për këtë studim, kanë qenë **912** të ftuar. Prej tyre **665 burra** dhe **247 gra**. E shprehur në përqindje, **73 % e të ftuarëve ne emisionet e monitoruara kanë qenë burra dhe vetëm 27 %, gra**.
- Pjesëmarrja më e ulët e grave shihet në emisionin 360° ndërsa ajo më e lartë në emisionin Opinion. Gjithsesi, pjesëmarrja e grave është shumë e ulët në të gjithë emisionet e vëzhguara për këtë studim, në raport me burrat.
- Pjesëmarrja e grave është më e madhe në ato emisione që konsiderohen se kanë edhe një element argëtimi apo tema sociale siç mund të jetë emisioni Opinion. Ndërkohë dy emisionet e tjera: Open dhe 360° e përshkruajnë veten si emisione ku trajtohen tema të forta politike dhe aktualiteti. Në këto dy emisione pjesëmarrja e grave është më e ulët.
- Ka një mungesë të madhe të pjesëmarrjes së grave në emisione që perceptohen se trajtojnë çështje me interes të madh politik dhe shoqëror.
- Në 14 emisione të monitoruara, nuk ka pasur asnjë grua të ftuar në emision, ndërkohë që në 21 emisione, ka qenë e ftuar vetëm një grua, përballë 4 ose edhe më shumë burrave.
- Analiza identifikoi 14 emisionesh të cilat mbajnë si titull emrin e një burri që është i ftuar në program (psh: Edi Rama, Ilir Meta, Sali Berisha, Sandër Lleshaj, Albin Kurti, Maks Velo, Erion Veliaj, etj). Në vetëm një rast, një pjesë e njërit prej emisioneve mbante si titull emrin e një gruaje (Monika Kryemadhi), por gjithsesi hapësira që i jepet realisht në emision personazhit është shumë e vogël krahasuar me pjesëmarrësit burra, në të njëjtin emision.
- Gjatë gjithë periudhës së monitorimit nuk ka pasur asnjë të ftuar i cili të vetëidentifikohet si anëtarë i komunitetit LGBTI, apo minoriteteve të tjera në Shqipëri. Një mungesë e madhe e zërave dhe perspektivave nga anëtarë të minoriteteve të tjera është një nevojë tejet problematike që duhet adresuar sa më parë në median shqiptare.

## TRAJTIMI

- Nga monitorimi i programeve u identifikua trajtim jo i barabartë (edhe në kuptimin cilësor përveç atij sasior), për gratë dhe burrat pjesëmarrës në program:
- Zakonisht moderatorët ia japin fjalën të parëve burrave, edhe në rastet kur e vetmja grua është pjesëmarrëse, mes 4 apo 5 burrave.

- Burrat flasin më gjatë dhe ndërpriten më pak. E kundërta ndodh për gratë, të cilat ndërpriten më shpesh si nga moderatorët ashtu edhe nga burrat e tjerë nëpër panele.
- Përgjatë emisioneve të ndryshëm, kur ka të ftuar burra dhe gra, vihet re një tendencë për t'i dhënë më shumë hapësirë pjesëmarrësve burra sesa grave. Kjo mund të shihet tek dy elementë: numri i pyetjeve drejtuar pjesëmarrësve të ndryshëm si dhe koha që iu lihet në dispozicion për të folur.
- Vihet re nga monitorimi, se burrat e intervistuar pyeten më së shumti për çështje profesionalizmi, apo përvoja të punës, ndërsa gratë e intervistuar (edhe pse mund të jenë në të njëjtin profesion) pyeten më shumë për rolet e tyre si mama, bashkëshorte apo çështje të tjera që mund të perceptohen si femërore.
- Zakonisht të ftuarit në studio që janë fizikisht prezent janë burra (për shkak të kufizimeve me pandeminë). Gratë në shumicën e herës lidhen me studion nëpërmjet skype apo mënyrave të tjera online.
- Vërehet edhe një mungesë e thellë e përfaqësimit të grave dhe zërit të tyre në disa prej temave dhe emisioneve që perceptohen si shumë të fortë dhe në studio ka vetëm burra.
- Drejtuesit e emisioneve (sidomos Opionion) kanë një tendencë për të bërë një zgjedhje që thekson ndasitë e roleve gjinore. Personazhet gra dhe vajza që vijnë kryesisht nga bota e artit dhe kulturës, pra hapësira të perceptuara si të lidhura me anën 'femërore' vihen përballë meshkujve nga profesione 'më të forta'. Edhe kur dy personazhe nje grua dhe një burrë vijnë nga fusha të ngjashme, mënyra e emërtimit të profesionit të tyre, prapë duket sikur i jep përparësi burrave.
- Një tendencë e tillë për t'i parë rolet gjinore si 'të ndara me thikë' përforcohet edhe nga narrativa e drejtuesit apo pjesëmarrësve në emision. Ka një ndryshim mes natyrës së pyetjeve që iu bëhen të ftuarëve burra dhe natyrës së pyetjeve që iu bëhen të ftuarave gra.
- Ka një tendencë për normalizimin e mendësive dhe përforcimin e mentalitetit ku gratë dhe vajzat shihen domosdoshmërisht si kontribuese të vetme në punët e shtëpisë dhe objektifikohen e shihen si pashmangshmërisht të lidhura me dukjen (pamjen) si një karakteristikë përcaktuese për to. Të tilla mendësi i përforcojnë qëndrimet seksiste ndaj grave dhe vajzave dhe e zvogëlojnë rolin dhe kontributin që ato mund të japin në shoqëri, në vetëm disa aspekte minimale, si p.sh. në punët e shtëpisë, siç duket qartë nga komentet e përmendura më sipër.

- Të ftuarat gra dhe vajza në emisionet e monitoruara përfaqësojnë një listë profesionesh e cila është më e kufizuar sesa ajo e burrave të ftuar në emisione.
- Ka një inflacion në përdorimin e titullit *kryetar* për profesionet e burrave i cili nuk gjendet pothuasje fare në profesionet e grave të ftuara në studio.
- Ndërsa për burrat e ftuar në studio përdoret përcaktimi *ekspert*, për gratë që janë në të njëjtën fushë dhe profesion, përdoret termi *specialiste*.
- Ka një tendencë për përforcimin e stereotipeve për rolet gjinore, që vërehet tek zgjedhja që iu bëhet pjesëmarrësve në emision.
- Vihet re në disa emisione që ka dallime në përmendjen e titujve për gratë dhe burrat apo për profesionet e ndryshme. Në disa raste, kur në emision ka burra dhe gra të të njëjtit profesion, prezantuesit e emisionit, zgjedhin t'i drejtohen burrit të ftuar sipas titullit që ka, kurse gruas së të njëjtit profesion, në emër ose fare pa titull.
- Ndërkohë, roli i burrit brenda shtëpisë apo roli që ai duhet të ketë si kryetar i familjes, vazhdon të përforcohet nga narrativa e të ftuarëve në emision.
- Duket sikur informacioni i dhënë nga burrat në studio, ka një vlerë më të madhe vërtetësie, sesa ai i dhënë nga gratë.

## Opinion- TV Klan

Përshkrim (siç shfaqet në faqen e programit)



*Opinion nga Blendi Fevziu. Emisioni politik më i ndjekur dhe më i preferuar në ekranet shqiptare. "Opinion" vjen në katër takime çdo javë – e hënë, e martë, e mërkurë dhe takimi tradicional i të enjtes mbrëma.*

*Çdo javë në studion e Tv Klan, komente, analiza, debate, intervista, personazhe, dëshmi dhe fakte konkrete. Ngjarjet më të fundit dhe më të rëndësishme në jetën politike dhe sociale të vendit, me debatet, opinionet dhe analizat e të ftuarve në studio.*

### Të dhëna të përgjithshme:

Për këtë studim u monitoruan 41 emisione të programit Opinion përkatësisht në datat:

MARS: 23, 25, 26, 30

PRILL: 1, 2, 6, 7, 8, 9, 13, 14, 15, 16, 20, 21, 22, 23, 27, 28, 29

MAJ: 4, 5, 6, 7, 11, 12, 13, 14, 18, 21, 26, 27

QERSHOR: 2, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 15

KORRIK: 1, 2, 6, 7, 8, 9

### VEZHGIME

Nga një analizë e shkurtër që mund t'i bëhet përmbajtjes së emisioneve shohim se gjithsej në emision ka pasur **376 të ftuar**, prej të cilëve **231 ose 61.5 % janë burra** dhe **145 ose 38.5 %, gra**. Duke qenë se emisioni është një nga më të ndjekurit në Shqipëri dhe trajton 'ngjarjet më të rëndësishme politike dhe sociale të vendit' përqindja më e lartë e burrave



pjesëmarrës, krahasur me gratë përforcon gjetjet e studimeve të mëparshme në këtë fushë që konfirmojnë mungesën e perspektivave të grave në jetën politike dhe sociale të vendit dhe një mbipërfaqësim të burrave.

**Nga 335 të ftuarit, në emision gjatë gjithë perudhës së monitorimit nuk ka pasur asnjë të ftuar i cili të vetidentifikohet si anëtarë i komunitetit LGBTI, apo minoriteteve të tjera në Shqipëri. Një mungesë e madhe e zeravë dhe perspektivave nga anëtarë të minoriteteve të tjera është një nevojë tejet problematike që duhet adresuar sa më parë në median shqiptare.**

Duke qenë se për shkak të pandemisë, që prej marsit 2020, në vend pati disa kufizime përsa i përket pjesëmarrjes në studio televizive dhe moslejimin e grupeve të mëdha, është interesant fakti që **zakonisht të ftuarit në studio në këtë emision ishin burra ndërkohë që gratë në shumicën e herës lidheshin me studion nëpërmjet skype apo mënyrave të tjera online.**

Një tjetër fakt që përforcon mendësitë ndarëse mes burrave dhe grave në shoqëri, duke i dhënë të parëve më shumë peshë dhe rëndësi, është edhe mënyra e emërimit të emisioneve. **Në të paktën pesë raste gjatë kësaj periudhe, si tituj emisionesh ka patur emra burrash, politikanësh.** Të tilla kanë qenë:

- Edi Rama per paketen ekonomike
- Sander Lleshaj?
- Edi Rama per hapjen e se henes
- Sali Berisha/ teatri
- Edi Rama per marreveshjen me opoziten

Asnjë nga emisionet e transmetuara gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur në emërtimin e vetë një emër gruaje. Kjo gjetje vjen si pasqyrim i realiteteve në shoqërinë shqiptare dhe pozicioneve që zënë gratë dhe burrat përkatësisht në shoqëri. Por duke e përforcuar këtë realitet edhe me emërtime të emisioneve, media dhe kryesisht këto lloj emisionesh që kanë një peshë të madhe në opinionin publik, mund të japin një kontribut të pashmangshëm në përforcimin dhe çimentimin e këëtyre realiteteve.

**Vërehet edhe një mungesë e thellë e përfaqësimit të grave dhe zërit të tyre në disa prej temave dhe emisioneve që perceptohen si shumë të fortë dhe në studio ka vetëm burra.** Konkretisht në emisionin e datës 4 Qershor, me temë: Edi Rama për marrëveshjen politike, ka vetëm katër burra të ftuar dhe asnjë grua. Pothuajse e njëjta gjë ndodh edhe për një tjetër emision politik i cili mund të konsiderohet me një temë të fortë, data 8 qershor ‘Elbasan, kush qelloi me snajper?’, në të cilin janë të ftuar 4 burra dhe vetëm një grua (Rudina Hajdari), por kjo e fundit nuk është ftuar për të marrë pjesë në diskutimin qendror që sugjerohet nga tema e emisionit. Në të njëjtën linjë janë edhe një sërë emisionesh të tjera të transmetuara gjatë kësaj kohe ku pjesëmarrëset gra kanë qenë në një minorancë të dukshme krahasuar me pjesëmarrësit burra për tema të cilat kanë një rëndësi të madhe

shoqërore dhe japin kontribut jo vetëm për informimin e publikut por edhe për të transmetuar mesazhe në lidhje më përfaqësimin gjinor dhe diversitetin në pikëpamje. Kështu për temën e datës 15 Prill 'A është gati vaksina?' ka 8 të ftuar burra dhe vetëm 2 të ftuara gra. Për temën 'Edi Rama për paketën ekonomike' të datës 16 Prill, ka 6 të ftuar burra dhe vetëm 2 gra. Për temën 'Sali Berisha/teatri' të datës 21 Maj, ka 6 të ftuar burra dhe vetëm 1 grua.

Interesant është fakti se edhe për çështje që nuk lidhen domosdoshmërisht me ngjarjet brenda vendit por që rreken të japin një pamje të realitetit të Shqiptarëve që jetojnë jashtë, sërish marrin përparësi burrat. Kështu në emisionin e datës 8 Prill, me temë 'Shkencëtarët Shqiptarë nëpër botë' në emision shfaqen 7 burra dhe 3 gra, si përfaqësues të këtij komuniteti, duke i qëndruar besnik perceptimit të krijuar brenda vendit dhe duke përforcuar mendësinë që edhe në këtë fushë, raportet gjinore janë të normalizuara siç reflektohen në realitetin shqiptar.

**Një tjetër gjetje që vjen si zgjedhje e drejtuesve të emisionit është edhe fakti se si personazhet vihen përballë njëri-tjetrit në këtë program.** Duke qenë se shumica e pjesëmarrësve nuk lejohej të ishin të pranishëm fizikisht në studio, një detaj për t'u konsideruar është edhe fakti se si drejtuesit e këtij formati zgjedhin të vënë në dritare të ekranit, personazhet meshkuj dhe femra. Një rast studimi interesant këtu është emisioni i datës 22 prill ku mes te ftuarëve ishin: Presidenti i Republikës, shefi i urgjencës në QSUT, ministrja e infrastrukturë dhe energjitikës, akademike, një pastor, dy moderatorë dhe një aktore. Në rrjedhën e emisionit, drejtuesit zgjedhin të vendosin në të njëjtin moment në ekran disa pjesëmarrës. Ndarja në atë pjesë të emisionit që kishte më shumë se sa një të inteervistuar konsistonte në:

-Skënder Brataj (shefi i urgjencës)- Bora Zemani (moderatore)

- Bora Zemani- Akil Pano (pastor)

- Blendi Salaj (producent)- Olta Gixhari (aktore)

**Siç mund të vërehet nga kjo ndarje, personazhet femra vijnë kryesisht nga bota e artit dhe kulturës, pra hapësira të perceptuara si të lidhura me femrat më shumë sesa me meshkujt. Ndërkohë meshkujt vijnë nga ato fusha që janë të perceptuara si të normalizuara për ta, pra profesione 'më të forta'.** Edhe kur dy personazhe nje femër dhe një mashkull vijnë nga fusha të ngjashme, psh Blendi Salaj- media dhe Olta Gixhari- teatër, pra të dy pjesë e kulturës, mënyra e emërimit të profesionit të tyre prapë duket sikur i jep përparësi burrave. Blendi Salaj emërtohet si *producent*, ndërkohë që Bora Zemani, e cila punon në të njëjtën fushë, në media, emërtohet si *moderatore*.

Një qasje e tillë e përballjes së burrave nga profesione që perceptohen si serioze, të forta, jetike për shoqërinë etj, dhe grave/vajzave nga profesione që perceptohen si të lidhura me argëtimin, pamjen etj, është edhe më e dukshme në emisionin e datës 29 Prill ku pjesëmarrës janë: Skender Brataj-shef i urgjences kombetare, Neritan Ceka-profesor, Redi Shehu-studiues, Bashkim Kadriu- mjek neuropsikiater dhe përballë tyre Floriana Garo-

prezantuese dhe Marina Vjollca-moderatore. Një ndarje e tillë pjesëmarrësish vetëm sa i përforcon hapësirat që perceptohen si domeine të burrave në shoqëri dhe ato që perceptohen si fusha ku gratë mund të japin kontributin e tyre.

Në të njëjtën linjë është edhe emision i datës 6 maj, ku përballë burrave të ftuar me profesione si mjekë, analistë, ekspertë ekonomie, psikiatër, shkrimtarë, etj, gratë dhe vajzat e ftuara janë të profesioneve: moderatore (2) dhe estetiste (2). Nuk ka asgjë të keqe në vetvete me këto lloj profesionesh apo faktin se ato janë profesione që më së shumti ofrohen nga gra dhe vajza, por **kur ky lloj përfaqësimi normalizohet nëpërmjet përsëritjes të të njëjtit model në ekrane shqiptare, atëherë ka një rrezik të madh që një mënyrë e tillë të menduarit të çimentohet dhe të shihet si natyrale. Kjo gjë do të krijonte vështirësi për çdo vajze e cila dëshirat, ambiciet dhe aftësitë i ka për një profesion tjetër, pikërisht për këto që perceptohen si terrene të meshkujve dhe do t'i privonte ato për t'u zhvilluar më tej në atë që dëshirojnë dhe meritojnë.**

**Një tendencë e tillë për t'i parë rolet gjinore si 'të ndara me thikë' përforcohet edhe nga narrativa e drejtuesit apo pjesëmarrësve në emision. Nëse i bëjmë një analizë natyrës së pyetjeve që iu drejtohen pjesëarrësve do të shohim që ka një ndryshim mes natyrës së pyetjeve që iu bëhen të ftuarëve burra dhe natyrës së pyetjeve që iu bëhen të ftuarave gra.**

Më konkretisht, në emisionin e datës 7 prill, me temë 'Edhe sa do të qëndrojmë të izoluar?', edhe pse në lidhje skype të ftuarit janë të gjithë doktorë dhe doktoresha të cilët punojnë jashtë Shqipërisë, drejtuesi i emisionit, më të ftuarit burra e nis bisedën duke e vënë theksin tek aftësitë dhe kredencialet e tyre, me pyetje si:

- 'Cfare specialiteti keni doktor dhe ku punoni ekzaktesisht?'
- Sa vite ne Katar?
- Dhe jeni drejtues bordi e nje kompanie qe merreni em hoteleri?, etj

Kurse për të ftuarat gra, edhe pse janë të të njëjtit profesion dhe pozitë, pyetjet nuk janë të lidhura me formimin e tyre:

- Ne cilin qytet ndodheni ne Norvegji?
- Sa kohe keni qe jeni vendosur aty?
- Cfare masash jane marre per koronavirusin?
- Ka alarm tek qytetaret?

Një shembull par-excellence i këtij fenomeni është edhe prezantimi që i bënë një mjekeje në emisionin e datës 9 prill:

*'Miss Anglia, nje vajze e bukur 28 -vjecare u kthye nga Anglia ku ndodhej ne sherbimin mjekesor te Anglise per te dhene kontributin e saj. Eshte kjo vajze ketu Miss Anglia 2019,*

*Basha Mukherie duhet te jete me origjine indiane, ka lene aktivitetin e saj te bamiresise dhe eshte kthyer ne spital per te punuar si mjekte prane kolegeve te saj... Doktoreshe kaq te bukur, nuk e di, edhe me covid 19 te jesh sherohesh'.*

**E njëjta narrativë sidomos për ndarjet e roleve gjinore vazhdon të përforcohet edhe përgjatë diskutimeve në emision apo komenteve të bëra nga prezantuesi apo të ftuarit. Më poshtë po japim disa shembuj të këtyre rasteve.**

Pyetje nga drejtuesi i emisionit:

'A gatuan Emina, besoj se merresh vetë me gatimin në shtëpi?'

'Ku krihen dhe lyhen për të gatuar gratë se nuk janë as të hapura parukeritë?' (emisioni i datës 1 prill).

'Me sa duket meshkujt nuk kanë patur shumë për të bërë punë, femrat janë kujdesur për shtëpinë duke ardhur rrotull, kanë bërë më shumë aktivitet fizik' (emisioni i datës 4 maj).

'Kanë punuar një cik në të zezë parukeritë, se shoh shumë gra që dalin të krehura, 2 muaj të mbyllura në shtëpi i shoh në tv të krehura e të rregulluara, nuk besoj që i ka krehur burri në shtëpi?' (6 Maj).

'Në karantinë, ku krihesh, ku lyhesh, ku rregullohesh, Spanja është pak më agresive në izolim?' (pyetje për Olta Gixharin në emisionin e datës 22 Prill).

Të gjitha këto komente të thëna nga drejtuesi i emisionit dhe të tjera të ngjashme që nuk janë pasqyruara këtu, nuk janë kundërshtuar apo komentuar nga asnjë nga pjesëmarrësit në emision apo nga të intervistuarit. **Kjo mënyrë rrëfimi jep një kontribut të madh në normalizimin e këtyrë lloj mendësive dhe përforcimin e mentalitet ku gratë dhe vajzat shihen domosdoshmërisht si kontribuese të vetme në punët e shtëpisë dhe objektifikohen e shihen si pashmangshmërisht të lidhura me dukjen (pamjen) si një karakteristikë përcaktuese për to. Të tilla mendësi i përforcojnë qëndrimet seksiste ndaj grave dhe vajzave dhe e zvogëlojnë rolin dhe kontributin që ato mund të japin në shoqëri, në vetëm disa aspekte minimale, si p.sh. në punët e shtëpisë, sic duket qartë nga komentet e përmendura më sipër.**

Në të njëjtën linjë dhe për ta përforcuar këtë lloj mendësie, që i vendos gratë dhe vajzat në pozicione të kufizuara në shoqëri, është edhe një shprehje e përdorur nga Kryeministri Edi Rama, gjatë emisionit të datës 16 prill. Pyetjes së gazetarit se ‘a do të lejohen të hapen klinikat dentare?’ Kryeministri i përgjigjet kështu:

‘Ajo që është e sigurtë është që kur të hapen do të hapen me një protokoll të përcaktuar me takime, me një axhendë, ata i bëjnë me takime por pa pasur të tjerë, **se ju e dini që floktoret janë edhe redaksitë më të rëndësishme të lajmeve të pashkruara në Shqipëri, dhe kështu që jo thjesht kontaminojnë lajmin por mund të kontaminojnë dynjanë atje duke u kapur me njëra-tjetrën se sa të bukura i ke flokët**’.

## Open, Eni Vasili, Top Channel

Përshkrim (siç shfaqet në faqen e programit)



*Programi “Open”, arena e debateve televizive për çështjet më të rëndësishme të politikës dhe aktualitetit, intervista me përfaqësuesit kryesor të shtetit dhe jo vetëm, dhe trajtimin e çdo çështjeje tjetër sensitive për shoqërinë tonë.*

*Çdo ngjarje e madhe politike, por edhe problematikat e aktualitetit apo tematikat e rëndësishme sociale marrin vëmendjen maksimale nga stafi “Open” për t’u përcjellë më pas tek publiku në mënyrën më profesionale të mundshme.*

*Një emision nga Eni Vasili*

### **Të dhëna të përgjithshme:**

Për këtë studim u monitoruan **43 emisione të Open**, përkatësisht në datat:

MARS: 24, 25, 26, 30, 31

PRILL: 1, 2, 6, 7, 8, 9, 13, 14, 15, 16, 20, 21, 22, 23

MAJ: 4, 5, 6, 7, 11, 12, 13, 18, 19, 20, 21

QERSHOR: 4, 8, 11, 15, 18, 22, 25, 29

KORRIK: 2, 6, 9, 13, 16

## VEZHGIME

Nga një analizë e shkurtër që mund t'i bëhet përmbajtjes së emisioneve shohim se gjithsej në emision ka pasur **420 të ftuar**, prej të cilëve **340 ose 81% janë burra dhe 80 ose 19%, gra**. Duke qenë se emisioni drejtohet nga një grua, ky raport në përfaqësimin e grave në këtë emision është pak surprizues. Nga literaturën e studimeve mbi përfaqësimin e grave në media rezulton se një nga faktorët që ndikon në përfaqësimin e ulët të grave dhe vajzave është edhe fakti se në shumicën e herës janë burrat ata që kanë në dorë proceset vendimmarrëse dhe i shohin proceset nga perspektiva e tyre, duke e legjitimuar këtë lloj perspektive dhe duke ndikuar edhe mënyrën se si shoqëria i sheh këto procese, pra nga këndvështrimi i burrave, shumicën e herës. Ndërkohë, në emisionin e drejtuar nga një grua, ne do të kishim pritur që perspektiva e saj si një grua të ishte më e pranishme në proceset vendimmarrëse për përfaqësimin në këtë emision, pra kush ftohet dhe për çfarë do të flitet. Por na rezulton që në këtë rast pjesëmarrja e grave dhe vajzave në program dhe si rrjedhojë edhe këndvështrimet e tyre mbi çështje më interes të madh për shoqërinë, janë të kufizuara dhe shumë në disavantazh, krahasuar me pjesëmarrësit burra dhe djem.

**Nga 420 të ftuarit, në emision gjatë gjithë periudhës së monitorimit nuk ka pasur asnjë të ftuar i cili të vetidentifikohet si anëtarë i komunitetit LGBTI, apo minoriteteve të tjera në Shqipëri. Një mungesë e madhe e zërave dhe perspektivave nga anëtarë të minoriteteve të tjera është një nevojë tejet problematike që duhet adresuar sa më parë në median shqiptare.**

Përveç pjesëmarrjes në terma sasiorë, duhet thënë që në terma cilësorë, edhe pse emisioni Open tenton të ketë një përfaqësim 'dinjitoz' të grave dhe vajzave që japin kontributin e tyre në shoqëri, sërish ka disa aspekte të cilat mund të vihen në dukje. Burrat e ftuar në studio gjatë kësaj kohe, përfaqësojnë një gamë të gjerë profesioneve dhe fushash në Shqipëri<sup>1</sup> si psh:

mjek; ministër i turizmit dhe mjedisit; kardiolog; analist; mjek; avokat; guvernator i Bankës së Shqipërisë; ekspert ekonomie; biznesmen; kreu i AK; jurist; ministër i diasporës; president i Kosovës; ministër i shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes; kryetar i dhomes së tregetisë/industries; eksperti ceshtjeve ekonomike; botues; drejtor News24; Kryetar i dhomes së prodhuesve të veshjeve; ekspert i shëndetit publik; infeksionist; epidemiolog; zëvendës kryeministër i Maqedonisë së veriut; Ish-ministër i shëndetësisë; ekspert financiar; mjek kardiolog; ministër i brendshëm; inxhinier telekomunikacioni; fizikant, etj.

**Ndërkohë për të ftuarat gra dhe vajza, lista e profesioneve është më e kufizuar dhe ato vijmë vetëm nga disa fusha të caktuara, si psh:**

---

<sup>1</sup> Kjo është vetëm një perzgjedhje e reduktuar e profesioneve, lista është shumë më e gjatë

Ministre e shendetesise dhe mbrojtjes sociale; gazetare; kirurge; kryebashkiake e Shkodres; Drejtore ISHP; mjekte/ pedagoge; Specialiste per sektorin financiar; Ministre e Financave; Sipermarrese; fasonerie; mjekte; shefe e sherbimit te epidemiologjise dhe kujdesit shendetesor, etj,.

Kuptohet që një zgjedhje e tillë është mjaft e kufizuar nga rrethanat dhe konteksti kur është bërë ky monitorim- që shumica e emisioneve i kushtoheshin pandemisë dhe situatës me koronavirusin Covid-19. Gjithsesi, nuk mund të mos vihet re se nga lista e profesioneve të burrave të ftuar në emision gjatë kësaj kohe, që ka disa profesione të cilat nuk gjenden fare të përfaqësuara në listën e grave dhe vajzave pjesëmarrëse në emision, si psh: botues, kardiolog, inxhinier, fizikant, etj.

**Gjithashtu ka një inflacion në përdorimin e titullit *kryetar* për profesionet e burrave i cili nuk gjendet pothuasje fare në profesionet e grave të ftuara në studio. Ndërsa për burrat e ftuar në studio përdoret përcaktimi *ekspert*, për gratë që ndoshta janë në të njëjtën fushë dhe profesion, përdoret termi *specialiste*.**

Një tjetër fakt që përforcon mendësitë ndarëse mes burrave dhe grave në shoqëri, duke i dhënë të parëve më shumë peshë dhe rëndësi, është edhe mënyra e emërimit të emisioneve. Në të paktën gjashtë raste gjatë kësaj periudhe, si tituj emisionesh, ose pjesë emisionesh, ka patur emra burrash, politikanësh. Të tillë kanë qenë:

- **Ilir Meta**
- Trajektorja **Meta**
- **Debat pas rrezimit te Albin Kurtit**
- Homazh per **Maks Velon**
- **Erion Veliaj**
- **Edi Rama/Qeveria Hoti**

Vetëm një prej emisioneve kishte emërtimin sipas një politikaneje grua: Monika Kryemadhi.

Ndërkohë me interes është analiza e emërimit të një prej emisioneve kushtuar koronavirusit titulli i të cilit ishte 'Një shqiptare në studimin amerikan për remdesevir'. Siç shohim nga ky përcaktim, është zgjedhur t'i jepet rëndësi kombësisë si element përcaktues duke lënë në plan të dytë faktin që është grua, dhe duke mos përmendur fare personin. Ky është një element që vjen si pasojë e asaj që audienca mendohet se vlerëson më shumë.

**Vërehet edhe një mungesë e thellë e përfaqësimit të grave dhe zërit të tyre në disa prej temave dhe emisioneve që perceptohen si shumë të fortë dhe në studio ka vetëm burra.**

Konkretisht në emisionet me temë:

- Hapja, si po funksionon?/ A deshtoi konsensusi per reformen zgjedhore?/ Kushti i PD, qeveria tranzitore/ Perplasja SHBA- Kine (**asnje grua**)
- A po largohet koronavirusi?/ Kanabisi mjekesor, frike apo mundesi?/ Reforma zgjedhore. A ka vullnet politik?/ (**9 të ftuar burra, asnjë grua**)



- A duhet te behen te gjitha bashkited e gjelbra?/ A do bejme plazh sivjet?/ Peshorja e kanabisit (**8 të ftuar burra, asnjë grua**).
- Shembja e teatrit ( **6 burra, asnjë grua**)
- Kthesa e papritur e Covid-19/ Turizmi, vonesa qe kushton (**6 burra, asnjë grua**)
- Si u perballem me Covid-19?/ A mjaftojne paketat e qeverise? (**12 burra, asnje grua**)
- Edi Rama/Qeveria Hoti (**3 burra, asnje grua**)
- Lista te hapura apo te mbyllura? (**5 burra, asnje grua**)
- Kulisat e opozites se re (**6 burra, asnje grua**)
- 15 kushtet e integritimit/ Ftesa amerikane per Kosoven (**5 burra, asnje grua**)

Për disa nga këto tema të cilat fokusohen tek përjetimet e shoqërisë përse i përket përballjes me pandeminë, të krijohet ideja sikur vetëm burrat po kalojnë një situatë të tillë kaq të rënduar. Kur pyesim 'Si u përballëm me COVID-19?' dhe ftojmë vetëm burra në studio për të folur për këtë temë, patjetër që do të na mungojnë perspektivat e grave dhe vajzave, për të mos folur për kategori edhe më vulnerabël brenda kësaj kategorie të gjerë, siç mund të jenë, gratë dhe vajzat e dhunuara, nënat e vetme, etj. Duke mos iu dhënë zë problemeve të tyre, edhe zgjidhjet dhe ndërjegjësimi për këto probleme, do të mungojnë.

**Në të njëjtën linjë janë edhe një sërë emisionesh të tjera të transmetuara gjatë kësaj kohe ku pjesëmarrëset gra kanë qenë në një minorancë të dukshme krahasuar me pjesëmarrësit burra për tema të cilat kanë një rëndësi të madhe shoqërore dhe japin kontribut jo vetëm për informimin e publikut por edhe për të transmetuar mesazhe në lidhje me përfaqësimin gjinor dhe diversitetin në pikëpamje. Kështu për temat:**

- Teatri shemb edhe reformat?/ Sistemi danez trazon politikën?(**7 burra dhe një grua**)
- A po largohet koronavirusi?/ Kanabisi mjekesor, frike apo mundesi?/ Reforma zgjedhore. A ka vullnet politik?/ (**9 te ftuar meshkuj, nje grua**).

**Përgjatë emisioneve të ndryshëm, kur ka të ftuar burra dhe gra, vihet re një tendencë për t'i dhënë më shumë hapësirë pjesëmarrësve burra sesa grave. Kjo mund të shihet tek dy elementë: numri i pyetjeve drejtuar pjesëmarrësve të ndryshëm si dhe koha që iu lihet në dispozicion për të folur.** Një shembull i kësaj mund të jetë emisioni i datës 2 prill me titull 'A po normalizohet kriza?' ku pjesëmarrëse është edhe ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ministres i bëhen gjithsej 7 pyetje, ndërkohë që Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, i cili mund të jetë personazhi me profilin më të lartë politik, pas ministres, i bëhen 14 pyetje, dyfishi. Në këtë emision është interesant fakti që dy grave të tjera që ishin pjesëmarrëse në këtë emision iu bëhen 5 pyetje në total, ndërkohë që numri i pyetjeve që iu bëhen pjesëmarrësve burra (pa numëruar pyetjet për guvernatorin) është 51, pra 10-fishi.

E njëjtja sjellje vërehet edhe në emisione të tjera. Edhe pse në emisionin e datës 4 maj, emri i Monika Kryemadhit është bërë edhe pjesë e emërimit të emisionit, hapësira që i dedikohet asaj, është shumë e vogël, me vetëm 6 pyetje.

Në emisionin e datës 8 prill me titull 'A duhen maskat?/ A rrezikojme kolaps ekonomik', ka 14 të ftuar burra dhe vetëm një grua. 11 prej të ftuarëve burra janë mjekë, ndërkohë edhe e vetmja e ftuar grua është mjekë. Në total mjekëve të ftuar iu bëhen 39 pyetje ndërkohë që

të ftuarës grua i bëhen vetem 2 pyetje, gjithsej. E njëjta tendencë përsëritet edhe në emisionet e datave 14 dhe 16 prill.

Në emisionin e datës 22 prill, me titull 'Kruja vatër', dhe pse emisioni lidhet me një fasoneri ku ka më së shumti gra të punësuar, në emision marrin pjesë për të folur 7 burra dhe dy gra. Burrat janë të gjithë biznemenë, kurse gratë janë përfaqësuesja e ministrisë së shëndetësisë dhe një gazetare. Intervistohet gjithashtu edhe një punonjëse e fasonerisë por në mënyrë anonime, duke mos dalë me fytyrë dhe duke mos treguar asnjë të dhënë gjeneraliteti.

Një tjetër rast interesant për të vërejtur diferenca në pjesëmarrjen e grave është edhe emisioni i datës 23 mars, ku shumica e të ftuarëve burra janë prezent fizikisht në studio dhe e vetmja e ftuar grua, lidhet nëpërmjet skype.

**Ka një diferencë edhe në natyrën e pyetjeve që iu bëhen të ftuarëve burra dhe të ftuarave gra.** Kështu në emisionin e datës 2 prill me temë 'Politika në kohën e koronës' burrave të ftuar iu bëhen pyetje për politikën, aktorët e ndryshëm politikë, situatën etj. Gruas së vetme të ftuar në emision i lihet një hapësirë shumë e kufizuar dhe i bëhen pyetje për çështje shumë të kufizuara.

**Ka një tendencë për përforcimin e stereotipeve për rolet gjinore, që vërehet tek zgjedhja që iu bëhet pjesëmarrësve në emision.**

Në emisionin e datës 7 maj me temë 'Kur do ti rikthehem normalitetit?/ Britania, e para në Evropë për vdekshmeri Covid/ Homazh për Maks Velon/ PD, biznesi i vogël në rrezik/ Protesta në kohën e Covid-19/ Bizneset: A mund ti përballojnë protokollet e hapjes', përballë ekspertëve burrave të ekonomisë janë të ftuara edhe dy gra vajza të cilat identifikohen me profesionet e make-up artist dhe showgirl (pronare e një qendre estetike).

E njëjta narrativë sidomos për ndarjet e roleve gjinore vazhdon të përforcohet edhe përgjatë diskutimeve në emision apo komenteve të bëra nga prezantuesja apo të ftuarit. Më poshtë po japim disa shembuj të këtyre rasteve.

Në emisionin e datës 9 prill, gjatë emisionit një nga të ftuarat në panelin online u shpreh se "gjatë atij postimi ku kërkova rrobaqepëse, kërkova ndihmë për hekurosje, kërkova ndihmë për ta prerë gjithë këtë telin, mendoja se do më ndihmonte një mashkull por u paraqit një femër e fortë, me muskuj dhe është duke ma prerë hekurin". Edhe pse në pamje të parë një shprehje e tillë ngjan si favorizuese për gratë dhe sfidon gjithë mendësinë ekzistuese për to në shoqëri, në fakt ajo paraqet disa probleme në lidhje me rolet gjinore. E para, presupozohet që disa profesione janë vetëm për gratë si psh: rrobaqepëse, hekurosje etj, ndërkohë që disa profesione të tjera që kërkojnë forcë më të shtuar fizike, janë vetëm për burra. Dalja nga ky ekuacion, siç është edhe rasti që paraqitet këtu nga e ftuara, vjen si përjashtim dhe për këtë shkak, edhe mes pjesëmarrësve shkakton të qeshura në emision. Fakti që një grua mund të jetë e aftë për të punuar edhe si hekurthyes, kthehet në objekt humori.

E njëjta mendësi në përforsimin e roleve gjinore vihet re edhe në emisionin e datës 13 prill, ku një prej të ftuarave, sipërmarrëse në një fasoneri, shprehet se “85% e punetoreve në fasoneri janë femra e ato nuk mund të punojnë në një ndërmarrje ndërtimi”.

E njëjta tendencë për të përforsuar rolet gjinore, sidomos ato që kanë lidhje me përkujdesin brenda mureve të shtëpisë apo për fëmijët, vihet re edhe në emisionin e datës, 26 mars, ku njëri nga të ftuarit pyetet për fëmijët dhe kujdesin ndaj tyre shprehet ‘Te pergjigjet Iliriana (gruaja) se merret me shume me kete pjese’.

**Vihet re në disa emisione që ka dallime në përmendjen e titujve për gratë dhe burrat apo për profesionet e ndryshme. Në disa raste, kur në emision ka burra dhe gra të të njëjtit profesion, prezantuesja e emisionit, kur iu drejtohet burrave përdor termin doktor, ndërkohë që kur i drejtohet të ftuarës grua (edhe ajo me profesionin doktorëshe) i thërret thjesht në emër (emisioni i datës 23 mars).**

E njëjta qasje vihet re në një tjetër emision të datës 30 mars ku të ftuar janë dy pedagogë, nga të cilët, burri i ftuar u prezantua me këtë titull (pedagog), ndërkohë që gruaja e ftuar, edhe pse pedagoge dhe me tituj të tjerë shkencore (kërkuese shkencore postdoktorale), prezantohet vetëm si psikologe.

Në emisionin e datës 31 mars, një batutë e njërit prej të ftuarëve të emisionit, e cila është shprehje e pastër homofobike, kalohet pa asnjë kundërshtim nga drejtuesja e emisionit apo ndonjë tjetër i ftuar në emision. Shprehja e thënë nga Spartak Ngjela “por diçka do fitojme, **se edhe ajo që puthet burri me burrë, ketu nuk mund të themi që është ndonjë zakon i mire**”, pritet me të qeshura nga të ftuarit dhe prezantuesja e emisionit.

Në emisionin e datës 19 Maj, një nga shprehjet e thëna nga një prej të ftuarëve në emision “Me vjen shume keq per qendrimin tuaj cinik si qytetare dhe **si grua**”, nxjerr në pah një nga mendësitë ekzistuese në Shqipëri ku shoqëria ka pritshmëri të ndryshme për qëndrimet e grave dhe burrave. Ndërkohë që burrave mund t’ju lejohet dhe është e pranueshme të jenë cinikë, të fortë në mendime, të shprehin hapur atë që mendojnë, për gratë kjo konsiderohet si diçka jo e zakonit. Ndërkohë edhe diferenca që bëhet nga i ftuari me shprehjen *si qytetare dhe si grua*, presupozon që këto dy kategori, janë të veçanta dhe shihen veç e veç.

**Ndërkohë, roli i burrit brenda shtëpisë apo roli që ai duhet të ketë si kryetar i familjes, vazhdon të përforsohet nga narrativa e të ftuarëve në emision.** Më konkretisht, në emisionin e datës 21 Maj, një nga të ftuarat thotë: “Pse pronar i Shqiperise eshte Sander Lleshaj? Te behet pronar ne shtepi te vet ai, **se as aty nuk e njohin si pronar**”. Kjo shprehje është e thënë nga një grua dhe si e tillë është dyfish më problematike, sepse tregon që hierarkinë e pozicioneve mes burrave dhe grave në familje, e cila favorizon dhe ka favorizuar në çdo kohë burrat, e shohin si të normalizuar edhe gratë. Ndërkohë, duke lënë mënjanë personin konkret që përmendet në emision, shprehja është tejet problematike pasi shpalos një mendësi tejet problematike në Shqipëri, ku burri jo vetëm shihet si kryetar i familjes dhe personi vendimmarrës, por edhe ‘pronar’ i familjes. Kjo i vë të gjithë anëtarët e tjerë, qofshin këto grua, familjarët apo fëmijët, në një pozicion pronësie, i cili ka pasoja edhe për mënyrën se si trajtohen anëtarët e tjerë në familje dhe të drejtat e tyre.

**Vihet re edhe një diferencë në llojin e pyetjeve që iu bëhet të ftuarave gra, në dallim nga ato që iu pyteten të ftuarëve burra. Për gratë pyetjet tentojnë të jenë më emocionale ose të lidhura me anën ‘femërore’. Shembuj të kësaj mund të gjenden të emisionin e datës 25 mars:**

- Si po e perjeton ti kete situatë kur shifrat që vijne nga Londra nuk janë aspak të mira?
- Ti po ofron asistencë psikologjike aktualisht.
- Jam kurioze çfarë kërkojnë njerezit? (etj)

**Ndërkohë duket sikur informacioni i dhënë nga burrat në studio, ka një vlerë më të madhe vërtetësie, sesa ai i dhënë nga gratë. Një rast interesant shfaqet në emisionin e datës 24 mars, kur prezantuesja ka pyetur përpara një të ftuar grua me profesionin doktoreshë dhe të njëjtën pyetje ‘Sa testimë behen në ditë ose në javë?’ ia bënë pak më vonë, të ftuarit burrë. Ai detyrohet të përgjigjet ‘Ashtu siç tha edhe kolegja ime...’.**

## **360 °, Artur Zheji, Ora News**

Përshkrim (siç shfaqet në faqen e programit)



*Polemikë, reflektim, investigim, debat, të vërteta të fshehura dhe të pathëna në studion e gazetarit të njohur Artur Zheji.*

*Emisioni transmetohet çdo të hënë dhe të enjte ora 21:00 ne [RTV Ora](#). Emisionet e Zhejit, shquhen për debatin e fortë dhe temat e mprehta politike dhe sociale, të cilat vendosin në fokus ngjarjet më të rëndësishme dhe ngërçet e pazgjidhura të shoqërisë shqiptare.*

### **Të dhëna të përgjithshme:**

Për këtë studim u monitoruan 19 emisione të 360 °

Mars: 2, 5, 30

Prill: 2, 6, 16, 20

Qershor: 1, 4, 8, 15, 18, 23, 26

Korrik: 2, 6, 9, 13, 16

Temat që janë trajtuar në emision (siç shfaqen në tituj gjatë secilit emision):

- **Shperthimi i Ilir Metes**
- Diktature apo demokraci?
- Virusi qe po ul ne gjunje Boten!
- Korona ose vrasësi i fillim-shekullit
- Sa dhe si, do vazhdoje kjo murtaje?!
- Konspiracioni i ri boteror? Po Shqiperia? (7 meshkuj, nje femer)
- Fitoi jeta? Po zbythet Korona?
- Corona connection: Ku e ka kufirin perdorimi I Policise
- Corona connection: Ligji I ri : Duan te rrezojne PD-PS
- Kush do ta votoje reformen Zgjedhore?
- Korona Virusi =Lufta dhe Diktatura
- Kush I 'semuri' vellezerit Budina?
- Etj...

## VEZHGIME

Nga një analizë e shkurtër që mund t'i bëhet përmbajtjes së emisioneve shohim se gjithsej në emision ka pasur **116 të ftuar**, prej të cilëve **94 ose 81 % janë burra dhe vetëm 22 ose 19 % gra**. Vihet re një disbalancë e theksuar për përfaqësimin e grave dhe vajzave në këtë emision i cili është edhe tejet problematik për sa i përket gjuhës së folur në emision, ku shpesh debatet e të ftuarëve degjenerojnë në gjuhë ofenduese dhe fyese dhe terma të cilët nuk respektojnë asnjë udhëzim për etikën në emisionet televizive apo edhe debatet publike.

**Nga 68 të ftuarit, në emision gjatë gjithë perudhës së monitorimit nuk ka pasur asnjë të ftuar i cili të vetidentifikohet si anëtarë i komunitetit LGBTI, apo minoriteteve të tjera në Shqipëri. Një mungesë e madhe e zeravë dhe perspektivave nga anëtarë të minoriteteve të tjera është një nevojë tejet problematike që duhet adresuar sa më parë në median shqiptare.**

Nga një analizë e shkurtër që mund t'i bëhet pjesëmarrjes së të ftuarëve në emisione shohim se në **3 prej emisioneve nuk ka asnjë të ftuar grua ndërsa në shumicën e emisioneve ka vetëm një të ftuar grua e vendosur përballë 4 apo më shumë burrave**. Nëse marrim parasysh edhe disa nga temat e emisionit të cilat supozohet të trajtojnë tema më

rëndësi për shoqërinë dhe aktualitetin shqiptar, i bie që perspektiva e grave dhe vajzave shqiptare për këto tema, është totalisht e munguar.

Siç u vu re në emisionet e trajtuara në këtë studim më sipër, edhe në këtë emision ka një rast kur një nga titujt e emisionit merr emrin e një burri, Presidentit të Republikës. Ndërkohë nuk ka asnjë emision që emërtohet sipas një gruaje.

Duke qenë se përmbajtja e emisionit dhe narrative e drejtuesit të këtij emisioni dhe të ftuarëve janë tejet problematike dhe duke mos respektuar asnjë udhëzim për etikën në programet televizive, ne nuk po preferojmë të bëjmë një analizë domethënëse të mënyrës se si çështjet gjinore specifikisht, janë trajtuar në këtë emision, pasi kjo do të ishte e pakuptimtë, por po paraqesim një përmbledhje të disa prej shprehjeve dhe thënieve të bëra në emision, ashtu siç janë shprehur nga të ftuarit apo drejtuesi i këtij emisioni.

Në përmbledhjen më poshtë, vihen re fraza homofobike, gjuhë përçarëse, gjuhë që përkrah dhe nxit dhunën etj.

#### *Emisioni i datës 2 prill:*

- I ftuari (Avokat): Ti po na e kthen si ai burri qe kishte 6 muaj pa bo sex me gruan **dhe ia futi tjetri nga mbrapa!**
- Prezantuesi: Mos flasim me banalitete seksuale
- I ftuari tjetër (Avokat)': Ja ku ndodhi në Greqi Syriza, cfare ishte Syriza! E dini se cfare ka shkruar shtypi grek për Tsiprasin? Fjalët më te qelbura, një budalla, një djalë, i bukur që do të shitet e tjera e tjera
- Prezantuesi: **I bukur ishte ai por jo gay!**

#### *Emisioni i datës 2 mars:*

Pjesë nga reagimi me editorial i prezantuesit të emisionit që merr shkas nga nje ngjarje e transmetuar në një tjetër emision për ngacmimin seksual të një të miture nga mësuesi I saj.

-... Kur lexoj që ka disa mësues shkollash, disa funderrina **që nuk meritojne të jetojne mbi këtë tokë**, flasin e flirtojne e përvetojnë me nxënësit e tyre, si te ishin prostituta, me ngjethet mishi dhe me ndizet gjaku. Si mundet të gjarperojnë në poret e shoqërise tone krejt të sëmurë **një flliqësire e tillë e pandëshkruar?** Si ka mundësi të ketë nga këto mësues përvers që shpërdorojnë nxënësit e tyre, vajza të mitura, **dhe nuk merren zvarrë, të pështyhen publikisht të lidhen në shtyllat e turpit?** Si ka mundësi të mos revoltohen dhe të mblidhen bashkë prindërit e atyre shkollave të cilët I kane besuar driten e syre te tyre? **A ka me një kod moral kjo shoqëri kurvash e kurvarësh të të gjitha niveleve, nga poshtë lart e nga lartë poshtë?** Apo morali i shqiptarëve, paska qenë thjesht një përallë e sajuar nga e

shkuara, sot një kuptim i përdhosur nga pornografia e mjeranëve që ka bërë folene në trutë e sëmura të kësaj shoqërie pa dinjitet? ...

#### *Emisioni i datës 5 mars*

(Një nga të ftuarit shprehet për një nga të ftuarat gra)

- Te ndash nje argument **te asaj, nje mediokre** e cila ve ne diskutim. Mua nuk me thane qe eshte ne tavoline se nuk vija me thane qe eshte XXX dhe thashe po, po kur **te me thone nje person nga tribuna nga rruga del ketu dhe do te debatoj me mua ketu Stop. Nuk ka njeri seri me sot te me vej mua ne levizje, funderrina dhe hidhuni perpjetë dhe beni cfare te doni!**

#### *Emision i datës 6 Prill*

Debati mes dy të ftuarëve, njëri në studio e tjetri nëpërmjet lidhjes online që u pasqyrua si lajme në disa media online, menjëherë pas këtij episodi:

- ...Po kujt i plasi se ke mbaruar shkencëtar ti XXX XXXX?
- Pse nxeheni?
- Aty ku luaj une tere fisi jot, tere origjina jote, te ngrihen nga varri, **po ik o pirdhu ti tani mos me bjer budallenj mua ne tv.**
- Po ik o budalla ik, po ik o budalla!
- Kam pas nje Enver Hoxha **qe me cau bythen.**
- Pa pasur **ate diplomën e pjerdhur qe ka ky** dhe e dyta je torollak Koci i Ollges ca dreqin je!
- **Po ik o budalla ik e di sa shkencëtarë rruge ka si ty apo jo?**

Në emisionin e datës 1 qershor, pezantuesi i drejtohet njërit prej të ftuarëve në emision, në formën e një komplimenti:

- **Z.Beto ti je shembulli i agresivitetit dhe i dhunës seksuale mashkullore nga e cila...**